Kastriot Myftaraj

KUSH ISHTE QEMAL STAFA ?

Kastriot Myftaraj. 1966 - 2022

5-Maj-2014

Kush ishte Qemal Stafa: një përkujtesë shqiptarëve dhe z. Arvizu i cili sot u bë i pari ambasador amerikan në Shqipëri që përmendi dhe nderoi emrin e Qemal Stafës

Sot Ambasadori ë SHBA në Shqipëri, Arvizu, në një takim me ushtarakë shqiptarë të cilët do të nisen për t' u trainuar në SHBA u bë i pari ambasador amerikan që përmendi me emër Qemal Stafën, kur tha: «Presidenti Wilson, një mik i shqiptarëve, është shprehur se ju nuk jeni ketu për të nxjerrë jetesën, ju ndodheni këtu për t' i mundësuar botës, për të jetuar në një vizion më të madh e me një frymë më të shkëlqyer shprese dhe arritjeje. Ju jeni këtu për të pasuruar botën. Presidenti Wilson po fliste për një përkushtim, më të madh se vetvetja, atë të shërbimit vetëmohues dhe të shpresës, për nje të ardhme më të mirë. Ky përkushtim i dedikohet atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit dhe kjo në Shqipëri shënohet si Dita e Dëshmorëve. Ndërsa kjo ditë kishte fillimisht si qellim të nderonte Qemal Stafën dhe për rrjedhoje edhe të gjithë të rënët në Luftën e Dytë Botërore, lista e dëshmorëve të Shqipërisë është rritur me sherbimin e vendit tuaj si aleat i NATO-s në Afganistan».

Nuk është rastësi që deri më sot asnjë ambasador amerikan në Shqipëri nuk e ka përmendur emrin e Qemal Stafës, aq më tepër në 5 maj. Kjo tregon se ambasadorët amerikanë në Shqipëri në këto 23 vite e kanë ditur mirë se cili ishte Qemal Stafa. Por që kjo gjë të ndodhë pikërisht sot në 2014, kur midis SHBA dhe NATO-s nga njëra anë, dhe Rusisë nga ana tjetër marrëdhëniet gjenden në atë pikë kritike që kanë qenë në ditët më të tensionuara të Luftës së Ftohtë, kjo të çon në disa përfundime shumë të hidhura. Nëse simbolizon diçka Qemal Stafa, ai simbolizon sigurisht njeriun i cili luftoi që Shqipëria të lidhej me Bashkimin Sovjetik, me Rusinë. Kjo është arsyeja që sot Ambasadori i Rusisë në Shqipëri mori pjesë në ceremoninë shtetërore të përkujtimit të dëshmorëve në Varrezat e Dëshmorëve, ku Kryeministri Rama dhe Ambasadori Rus vunë kurorë te Monumenti ë ashtuquajtur i Nënës Shqipëri, që është një femër e modelit të monumenteve sovjetike e cila mban në dorën e ngritur lart një yll të kuq sovjetik, dhe që nuk ka asnjë simbol kombëtar shqiptar. Monumenti, autor i të cilit është babai i Kryeministrit të sotëm, Kristaq Rama, është ndërtuar në kohën e diktaturës komuniste dhe simbolizon parimin bazik marksist, të sanksionuar në "Manifestin Komunist" se "Komunistët nuk kanë atdhe"!

5 maji është dita zyrtare e përkujtimit të dëshmorëve në Shqipëri. Origjina e kësaj dite përkujtimore është në vendimin e Komitetit Qendror të PPSH të datës 7 korrik 1959, që e shpalli këtë ditë si festë zyrtare. Në këtë vendim thuhej: «Me qëllim që dëshmorët e luftës të përkujtohen nga gjithë populli të caktohet si ditë pelegrinazhi në varrezat e tyre-5 maji-dita e vrasjes së Qemal Stafës». (cituar sipas: «Dokumente kryesore të PPSH», botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë 1970, Volumi i tretë, f. 248)

Me këtë vendim të një instance ideologjike dhe jo shtetërore, 5 maji nuk ishte dita e përkujtimit dhe nderimit të krejt dëshmorëve të gjithë luftërave në historinë e kombit shqiptar, por vetëm

të dëshmorëve të asaj që u quajt nga regjimi komunist «Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare», pra të dëshmorëve komunistë dhe partizanë që mbanin yllin e kuq si simbol. Deri në vitin 2000 nuk ekzistonte asnjë ligj shtetëror me të cilin 5 maji të ishte ditë përkujtimore e dëshmorëve. 5 maji u bë ditë e nderimit të dëshmorëve të të gjitha luftërave kombëtare, vetëm me Ligjin 8607, dt. 27 prill 2000, neni 6 ë të cilit thotë: «Dita përkujtimore e dëshmorëve të atdheut është 5 maji».

Kështu, 5 maji, dita e vrasjes së Qemal Stafës, është sot dita zyrtare e përkujtimit të dëshmorëve shqiptarë të të gjitha luftrave për liri dhe pavarësi kombëtare. Qemal Stafa, si person, dhe episodi i vrasjes së tij nuk ishte as i një rëndësie dhe vlere të tillë që të shërbente për përkujtimin e dëshmorëve të Luftës së Dytë Botërore, e jo më të të gjitha luftërave për liri dhe pavarësi kombëtare! Qemal Stafa jo vetëm që ishte komunist, por ai i përkiste një grupi të ngushtë të lëvizjes komuniste shqiptare, komunistëve stalinistë, pra ekstremistëve të lidhur me Kominternin, Internacionalen III Komuniste me qendër në Moskë. Qemal Stafa nuk ishte pjestar i asnjë formacioni luftarak partizan, por vetëm anëtar i një forumi partiak që ishte Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Qemal Stafa kur u rrethua në një shtëpi në Tiranë, nuk ishte duke kryer veprimtari antifashiste, por një orgji ku merrnin pjesë gjashtë ilegalë komunistë, që kishte «koinciduar» të ishin tre djem dhe tre vajza. Qemal Stafa nuk vrau asnjë fashist, kur u rrethua shtëpia, ai thjesht kërkoi të ikte dhe u vra pas shpine.

Por cili ishte Qemal Stafa, njeriu me të cilin është e lidhur dita e përkujtimit të dëshmorëve të atdheut të të gjitha kohërave? Qemal Stafa u bë i famshëm në Shqipëri dhe jashtë saj si komunist i vendosur dhe i deklaruar publikisht, kur në 4 shkurt 1939, deklaroi para Gjykatës Speciale për krime politike në Tiranë, ku kishte dalë si i pandehur në atë që u njoh si gjyqi i komunistëve (i pari gjyq i këtij lloji që mbahej në Shqipëri): «Akuzat që më atribuohen figurojnë të gjitha ndër procese të cilat i pranoj dhe deklaroj se jam komunist i bindur, komunizmi ka me e shpëtue gjendjen e sodshme». (cituar sipas: «Heronj të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare». Përmbledhje dokumentesh, Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1984, f. 21)

Prania e Qemal Stafës në këtë gjyq është e lidhur me disa ngjarje të çuditshme, që të bëjnë me dije për dorën e fshehtë të shërbimit sekret të Zogut, që e komandonte atë si kukull me fije. Në kohën kur filluan arrestimet masive të komunistëve në Shqipër, në verën e vitit 1938, Qemal Stafa porsa kishte mbaruar shkollën e mesme në Gjimnazin e Tiranës dhe kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit për të marrë një bursë për të kryer studimet universitare jashtë vendit. Në korrik 1938 Qemal Stafa arrestohet si komunist, në Elbasan. Në të vetmen monografi që është shkruar për Qemal Stafën në kohën e regjimit komunist, nga Nasho Jorgaqi, nën kujdesin personal të Nexhmije Hoxhës, për këtë episod thuhet: «Në shkresën sekrete të datës 8 korrik 1938, të firmosur nga komandanti i përgjithshëm i Gjindarmërisë, vihet në dijeni dikasteri i arësimit se Qemal Stafa figuron në listën e atyre personave me ndjenja komuniste të mbajtun

prej kësaj komande dhe tash po ato ndjenja ka».(Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 191)

Pra, Qemal Stafa, 18 vjeçar, ishte i njohur nga shteti monarkist si komunist. Qemal Stafa e kishte filluar shkollimin e vet në vitin 1925, si nxënës i Kolegjit Saverian të Etërve Jezuitë, në Shkodër, ku jetonte familja e tij se i ati ishte me punë oficer. Këtë kolegj Qemal Stafa e ndoqi për tetë vite, duke qenë në atë kohë një ndër të paktët nxënës muslimanë, derisa në vitin 1933 u mbyllën shkollat private të mbajtura nga klerikët, prandaj kaloi në Gjimnazin e Shtetit. Në kolegjin jezuit para Qemalit tashmë studionte dhe vëllai i madh, Veliu. Në këtë kolegj, gjuha kryesore veç shqipes ishte italishtja. Në kohën që Qemal Stafa kalonte në Gjimnazin laik të Shkodrës, Mbreti Zog ishte në marrëdhënie mjaft të këqija me Klerin Katolik, që e shikonte si një goditje ndaj kulturës katolike, reformën arsimore të Zogut, që kishte për synim laicizimin e arsimit në Shqipëri. Kleri katolik arriti deri atje sa ta paditë shtetin shqiptar pranë gjykatës ndërkombëtare të Lidhjes së Kombeve (ekuivalenti i OKB). Atëherë kleri katolik përdorte kundër reformës së Zogut edhe kartën antikomuniste, do të thotë se në shkollat laike nxënësit e ikur nga shkollat katolike do të infektoheshin nga komunizmi. Se për klerikët katolike shkollat laike, duke predikuar praktikisht ateizmin ishin mjedisi i përshtatshëm për kultivimin e ideve komuniste. Zogu, për t' ia hequr këtë kartë katolikëve, deshi të tregonte se komunistë mund të kultivohen dhe në shkollat e tyre.

Në vitin 1935 në Shkodër dhe në Shqipëri bëri bujë një ngjarje e pazakonshme për kohën. Një nxënës i ardhur në Gjimnazin shtetëror të Shkodrës, nga kolegji saverian jezuit, Qemal Stafa, bëri një hartim që bëri bujë dhe që u quajt si bolshevik. Hartimi ishte një trajtim i lirë mbi temën «Të rinjtë dhe pleqtë», të dhënë si detyrë në shkollë. Qemal Stafa zgjodhi për hartimin e vet tre vargje nga drama «Vilhelm Tel» e Shilerit, që po atë vit ishte vënë në skenë nga trupa amatore teatrale e Gjimnazit. Vargjet qenë ato që thotë aristokrati Antinghausen kur dëgjon për kryengritjen e fshatarëve kundër sundimit të Habsburgëve: «Liri e re më e mirë do të blerojë./E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë/Një jetë e re po lulëzon gërmadhash».

Në hartimin e vet Qemal Stafa madje guxoi të lavdëronte Rusinë Bolshevike të kohës, çka do të thoshte se vetëdeklarohej si komunist. Në hartim thuhej: «Asht një gja e domosdoshme të ndryshojmë ndamjen e sotme të pasunisë (gja e vjetër) e ta zavendësojmë me një ndamje të re e të njënjishme (gja e re). Rusët e kanë ba me kohë; shembull se e vjetra shembet. Edhe na do ta bajmë». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 88-89)

Për një gjë të tillë minimalisht regjimi diktatorial antikomunist i Zogut duhet ta kishte përjashtuar nga shkolla dhe ta kishte dëbuar nga Shkodra së bashku me familjen, siç qe

praktika për raste më pak të rënda. Por e vetmja gjë që i ndodhi Qemal Stafës ishte: «Nuk vonoi dhe një ditë, në mes të orës së mësimit, nxënësin e klasës V-A e thirrën në drejtori. Titullari i shkollës, i cili ishte informuar me hollësi për gjithçka, hodhi mbi të një breshër të pafund qortimesh, duke e këshilluar me një ton të përmbajtur që të hiqte dorë nga 'idenat ekstremiste që përmbajnë një rrezik për shoqninë e për rendin publik'... Drejtoria e gjimnazit do të kish marrë me siguri një masë të rreptë kundrejt Qemalit, po meqë hartimi kish bërë bujë dhe një masë publike do të shtonte popullaritetin e djaloshit, u detyrua ta mbylli me kaq». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 91-92)

Kështu thotë literatura e kohës së regjimit komunist. Shumë i shkathët ky Nasho Jorgaqi, autori i romanit sigurims «Mërgata e qyqeve»! Të çuditshëm këta skribët komunistë! Kur u intereson, për të justifikuar pikat e errta të heronjve të tyre, e nxjerrin regjimin e Zogut sikur të ishte një regjim liberal, si Zvicra apo Suedia e asaj kohe! Regjimi i Zogut na paska pasur frikë nga popullariteti i gjimnazistit Qemal Stafa, prandaj nuk e ndëshkoi atë! Për të kuptuar se sa e rëndë ishte ajo që bëri Qemal Stafa, imagjinoni sikur një gjimanazist në kohën e regjimit të Enver Hoxhës, të bënte një hartim ku të lavdëronte SHBA, dhe të thoshte se në Shqipëri gjërat duhet të përmbyseshin dhe të bëheshin sipas modelit amerikan! Çfarë do t' i ndodhte këtij njeriu dhe familjes së tij? duhej Derisa Qemal Stafa nuk u ndëshkua, as minimalisht, tregon se ai e kishte bërë këtë trimëri me porosi të shërbimit sekret të Zogut. Qemal Stafa duhet të jetë rekrutuar nga shërbimi sekret i Zogut që kur erdhi në Gjimnazin shtetëror. Shërbimi sekret i Zogut, edhe për shkak të mungesës së universiteteve në vend, i survejonte fort shkollat e mesme, duke i parë si vende ku mund të depërtonin idetë komuniste. Dhe nuk e pati gabim. Që pas këtij hartimi Qemal Stafa fitoi reputacionin e të qenit komunist. Që në 1934, në moshën 14 vjeçare, tashmë ai pati hyrë në lëvizjen komuniste, sipas librit të Nasho Jorgaqit, «Qemal Stafa» (f. 71), duke u bërë anëtar i Grupit komunist të Shkodrës.

Në 1936 Qemal Stafa, për shkak se një vit më parë i kishte vdekur i ati, shkoi me banim në Tiranë, së bashku me familjen, ku vazhdoi shkollën në gjimnazin shtetëror të kryeqytetit, ku u pranua pavarësisht incidentit që pati në Shkodër. Në Gjimnazin e Tiranës ai vazhdoi veprimtarinë revolucionare, duke u lidhur me degën e Grupit komunist të Shkodrës, atje. Në verën e vitit 1938, në kohën që Qemal Stafa mbaroi shkollën e mesme dhe po bënte përpjekje për të siguruar një bursë për studime të larta jashtë vendit, në Shqipëri filluan arrestimet masive të komunistëve. Deri më atëherë Mbreti Zog e kishte toleruar një lëvizje të vogël komuniste në Shqipëri, në mënyrë që të paraqitej para Perëndimit si bastion kundër komunizmit. Por në vitin 1938 Zogu kishte filluar të ndjente presionin e fortë italian që do t' i paraprinte pushtimit, një vit më pas. Zogu donte t' i hiqte Italisë çdo shkak për të justifikuar pushtimin e Shqipërisë, gjë që Italia mund ta bënte legalisht, sipas së drejtës që i kishte dhënë Këshilli i Lidhjes së Kombeve në vitin 1921, duke e quajtur destabilitetin në Shqipëri, si cënim të sigurisë strategjike të Italisë. Italia, që atëherë ishte bashkuar me Paktin Anti-Komintern, gjermano-japonez, me arsyen se veprimtaria e komunizmit ndërkombëtar me qendër në Moskë,

përbënte rrezik për sigurinë e këtyre vendeve, mund të përdorte si pretekst për të futur trupa shtimin e veprimtarisë komuniste në Shqipëri, duke e parë këtë si rrezik për sigurinë e saj.

Prandaj Zogu ndryshoi politikën ndaj komunistëve, duke filluar një goditje, gjithsesi më tepër teatrale ndaj tyre. Në këtë fushatë antikomuniste u arrestua dhe Qemal Stafa në korrik 1938, për t' u liruar vetëm pas disa ditësh, edhe pse ishte komunist i njohur. Qemal Stafa jo vetëm që nuk u mbajt në burg, së bashku me shokët e tij komunistë, por atë vit atij iu dha një bursë shtetërorë për të kryer studimet universitare në Itali. Qemal Stafa shkoi në Itali ku filloi studimet për drejtësi në Universitetin e Firences. (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 201)

Kjo do të thotë se atë nuk kërkonin që ta arrestonin si komunist në kohën që Regjimi i Zogut kishte nisur gjuetinë e komunistëve, dhe një ndër të parët që duhej të arrestohej ishte ai, komunisti i deklaruar Qemal Stafa! Pas të gjitha gjasave bursën e shtetit shqiptar, Qemali e mori si agjent i shërbimit sekret të Zogut. Ndryshe ku do t' i gjente paratë për të shkuar me studime jashtë vendit Qemal Stafa, kur ai kishte vetëm me nënën e papunë, ndërsa babai që ishte ushtarak, i kishte vdekur në 1935, duke mos i lënë pasuri. Në vitin 1938, kur Qemal Stafa shkoi me studime jashtë vendit, vëllai i tij më i madh, Veliu, mbaroi studimet për mjekësi në Itali, dhe shkoi për kurim në një senatorium në Paris, se vuante nga tuberkulozi (do të vdiste një vit më pas). Nga Italia, po atë vit, Qemal Stafa, siç thotë Nasho Jorgaqi, shkon në Paris, në selinë e Komitetit Qendror të PKF, ku merr takime, për të marrë udhëzime nga Kominterni, për lëvizjen komuniste shqiptare. Qemal Stafa vjen në Shqipëri, në mes të vitit shkollor, në janar 1939, në kulmin e fushatës për arrestimin e komunistëve. Në monografinë për Qemal Stafën thuhet: «Sapo u kthye në atdhe, Qemali u ndodh para një situate të rëndë: gjindarmëria zogiste kishte filluar arrestimin në masë të komunistëve». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 210)

E vërteta është që arrestimet në masë kishin filluar që në verën e vitit të kaluar (1938) kur Qemal Stafa u arrestua dhe u lirua në mënyrë misterioze. Po kaq misterioz është dhe kthimi i tij në Shqipëri në janar 1939, kur arsyeja e donte që ai të rrinte larg Shqipërisë, për t' i shpëtuar arrestimit. Dhe Qemal Stafa u arrestua në janar 1939 dhe doli në gjyqin e quajtur të komunistëve. Me sa duket ai u kthye me mision, që kuptohet nga karakteri që regjimi i dha gjyqit. Regjimi i Zogut donte që me anë të këtij gjyqi të krijonte idenë sikur komunizmi në Shqipëri e kishte qendrën në Shkodër dhe se katolikët, ose njerëzit e formuar në mjedise katolike ishin komunistët më të rrezikshëm, ndërsa ai Zogu duhej si dorë e fortë për ta frenuar këtë lëvizje komuniste. Në gjyq si komunisti më i rrezikshëm dhe që u dënua më rëndë doli katoliku Zef Mala. Qemal Stafa, me reputacionin e komunistit të krijuar nga hartimi i tij i famshëm, përfaqësonte në gjyq muslimanin e infektuar nga komunizmi në një shkollë katolike dhe në një mjedis katolik. Në gjyq Qemal Stafa bëri deklaratën e famshme se ai është komunist

dhe se beson se vetëm komunizmi do ta shpëtojë Shqipërinë. E megjithatë gjyqi e dënoi Qemal Stafën vetëm gjashtë vjet burg, të cilat iu zbritën në tre, pasi autoritetet mbyllën sytë para trukut që bëri avokati i Qemal Stafës, Suat Asllani, kushëriri i parë i ish-Ministrit të Punëve të Jashtme të Zogut, Fuat Asllanit, që paraqiti në gjyq një çertifikatë false ku thuhej se Qemal Stafa kishte lindur në vitin 1921, çka bëri që t' i zbritet dënimi përgjysëm, për shkak se nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç. Kjo gjë pranohet tërthorazi dhe në monografinë e Nasho Jorgaqit për Qemal Stafën (f. 229), ku thuhet se gjyqi mori parasysh një dokument të ardhur nga Elbasani, që jepte si të dhënë për datlindjen vitin 1921.

Kështu që kthimi i Qemal Stafës në Shqipëri në janar 1939 dhe qendrimi i tij spektakolar në gjyq ishte një kombinacion agjenturor. Qemal Stafa veproi në gjyq si agjent provokator, se pasi ai bëri deklaratën e famshme, edhe të tjerët filluan të deklarojnë hapur në gjyq se ishin komunistë, gjë që ishte saktësisht ajo që i duhej regjimit. Regjimi zogist e lejoi Qemal Stafën në 2 prill 1939 që të marrë pjesë në varrimin e vëllait, Veliut. (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 241)

Në kohën e regjimit komunist shqiptar kjo gjë as që mendohej për të dënuarit politikë, që nuk u gjendej as varri kur pushkatoheshin nga regjimi. Qemal Stafa u arratis nga burgu në 7 prill 1939, duke përfituar nga rrëmuja që pasoi ikjen e Mbretit Zog, ndërsa po zbarkonin trupat italiane në Shqipëri. Komunistët e ikur nga burgu në prill 1939, duke përfshirë dhe Vasil Shanton, arratisen në Jugosllavi, duke pasur frikë se fashistët italianë do t' i trajtonin komunistët ashtu si në Spanjë, ku i pushkatonin pa gjyq në grupe. Qemal Stafa nuk arratiset në Jugosllavi si komunistët e tjerë, të ikur nga burgu, por rri në Tiranë dhe pret amnistinë që pritet të bëjnë italianët. (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 248-249-251-252-253)

Ky qendrim i Qemal Stafës është justifikuar me atë se u plagos gjatë arratisjes nga burgu, pasi një xhandar qëlloi me armë. Kjo është gënjeshtër, se asnjë xhandar nuk kishte ndërmend të qëllonte kur burgu ishte braktisur nga drejtuesit e tij. Qemal Stafa qendroi në Shqipëri se ai kishte garanci nga italianët, dhe garancinë e pati marrë gjatë kohës kur shkoi me studime në Itali, vjeshtën e kaluar. Pra, Qemal Stafa ishte bërë agjent i dyfishtë, edhe italian, përveçse i shërbimit sekret shqiptar të kohës. Edhe shokët e Qemal Stafës u kthyen pas amnistisë dhe nuk u ndodhi gjë. Italisë fashiste të Musolinit i duhej një lëvizje komuniste në Shqipëri, në thelb po për ato arsye që i duhej Zogut. Musolini donte t' u thoshte fuqive perëndimore se në Shqipëri ekzistonte një rrezik komunist dhe se pushtimi i vendit nga Italia ishte i nevojshëm për ta shmangur atë. Pra, lëvizja komuniste në Shqipëri bëhej pjesë raison d' etre të Fashizmit, rrezikut komunist ndërkombëtar. Gjithashtu, italianëve u duhej një lëvizje komuniste në Shqipëri, e toleruar deri në një përmasë diskrete, për t' i mbajtur shtresat e larta dhe të mesme, si dhe intelektualët antikomunistë shqiptarë të lidhur pas Italisë fashiste, të cilën do ta shikonin

si mbrojtëse të Shqipërisë nga komunizmi.

Regjimi fashist në Shqipëri i joshi komunistët me poste dhe benefite të ndryshme, dhe këta të fundit e bënë «Paktin Molotov-Ribentrop» para se ta bënin Moska dhe Berlini. Enver Hoxha mori një lejë për tregëti cigaresh me shumicë, gjë që në atë kohë ishte një gjë mjaft fitimprurëröse dhe quhej si privilegj i madh, se duhani ishte monopol i shtetit. Qemal Stafa nuk bëri përjashtim nga prirja e komunistëve për bashkëpunim me regjimin fashist. Në monografinë e Nasho Jorgaqit thuhet: «Vetë Xhovani Xhiro, organizator i rinisë fashiste, u përpoq ta afronte Qemalin. Në rrugë të tërthorta e të drejtpërdrejta, ai i ofroi pozita shtetërore të rëndësishme, por Qemali nuk pranoi kurrsesi. Ai refuzoi çdo lloj nëpunësie në aparatin shtetëror të pushtuesve». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 255-256)

Eh, burrë i zgjuar ky Nashoja i «Mërgatës së qyqeve»! Qemal Stafa atëherë donte para së gjithash që t' i jepej e drejta për të vazhduar shkollën e lartë që e pati ndërprerë pas arrestimit. Për këtë ai flirtoi me fashistët. Nasho Jorgaqi shkruan: «Sa për të mos ndenjur pa punë, po më shumë që të njihej nga afër e të blente prej tyre, Qemali u dha për një kohë mësime të gjuhës shqipe disa aviatorëve italianë». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 256)

Nashoja i «Mërgatës së qyqeve» duhet ta dijë se po të përdorim logjikën e «Manush Kelmendit», alias Isuf Mullait, këtu del saktë se Qemali ka punuar përkthyes i ushtarakëve italianë, se pilotëve italianë nuk u duhej që të mësonin shqip, kur ishin shqiptarët ata që mësonin italisht. Kështu del se Qemali ishte njeriu i OVRA, shërbimit sekret fashist, se vetëm një njeri i tillë mund të kishte privilegjin të punonte përkthyes me aviatorët italianë. Dhe për të fituar dashamirësinë e fashistëve Qemali arriti deri atje sa të botonte shkrime në gazetën «Fashizmi», organ i Partisë Fashiste Shqiptare, anëtar i së cilës u bë Qemali. Nasho Jorgaqi shkruan: «Atëherë u gjet një ish-bashkënxënës i Qemalit i viteve të Shkodrës, agjent i fashistëve, Lazër Radi, të cilit i kishin mbetur disa shkrime nga koha e gjimnazit të Shkodrës dhe ndërmjet tyre skica letrare 'Rreze frëngjijash'. Skicën Lazër Radi e botoi arbitrarisht në fletushkën 'Fashizmi'. Ky ishte një incident që e revoltoi pa masë Qemalin, sepse dukej haptazi qëllimi mashtronjës i fashistëve». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 258)

Kjo është si ato përrallat e atij personazhit të «Mërgatës së qyqeve», të marrit Daut në kafenenë e mërgatës! Askush nuk e beson që Lazër Radi na paska ruajtur një shkrim të Qemalit që nga vitet e Gjimnazit dhe e paska botuar pa lejen e këtij të fundit! Dhe për më tepër kur pas botimit në gazetën «Fashizmi» Qemalit iu dha e drejta të rifillonte studimet në Itali me bursën e regjimit fashist. Nasho Jorgaqi për këtë thotë: «Një vit më parë Qemali ishte regjistruar në

fakultetin e drejtësisë të Universitetit të Firences. Në rrethet komuniste në muajt e parë të pushtimit fashist diskutohej cështja, nëse duhej të vinin shokët për studime në Itali. Lufta kundër fashizmit akoma nuk kish marrë forma të organizuara... Grupi i Shkodrës dha orientime që shokët të shkonin për studime në Itali... Ata jo vetëm do të pajiseshin me kulturë e do të fitonin horizont, po vajtja atje po të shfrytëzohej si duhet, do t' i shërbente njohjes në vend të fashizmit. Si pasojë, ata do të dinin ta demaskonin e ta luftonin më mirë armikun në atdhe». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 261)

Bukur! Por duket se komunistët kështu po i merrnin fashistët për idiotë! Se si do ta toleronte Fashizmi këtë komunist të deklaruar, që të vinte edhe në universitetet e Italisë dhe të bënte subversion?! Dhe përse në Shqipëri komunistët nuk fillonin luftën e organizuar në vitin 1939? Se atëherë u bë Pakti Molotov-Ribentrop, pas të cilit komunistëve në gjithë botën, duke përfshirë dhe Shqipërinë, u erdhi urdhëri nga Moska që të ndërprisnin çdo veprim, qoftë edhe verbal kundër fashizmit. Kështu Qemali në shtator 1939 shkon në Itali për studime. Nasho Jorgaqi shkruan: «Fashistët i nxorrën mjaft pengesa. Bile nuk donin ta linin për të kaluarën e tij si komunist, por duke mos pasur fakte të reja, u detyruan t' i jepnin pasaportën».

Shumë zemërgjerë këta fashistët me komunistin e deklaruar Qemal Stafa! Dhe kjo në kohën që shqiptarë të tjerë jokomunistë, por antifashistë ishin duke i internuar në ishujt e Italisë, duke përfshirë dhe komunistë të padëgjueshëm ndaj Moskës si Zai Fundo. Nasho Jorgaqi nuk thotë se me ç' pare shkoi Qemali për studime në Itali kur në shtëpi kishte vetëm nënën e ve, që jetonte me qera, dhe nuk kishte pasuri. Duket qartë se shkoi për studime universitare me paratë e Fashizmit.

Në 17 maj 1941 Policia e Tiranës do t' i kumtonte Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për Qemal Stafën: «Studenti universitar në objekt, banues këtu, është aktualisht në Firence për arsye studimi, i shënuar në Rubrikën e Kufirit me masën paraprake: 'Të ndiqet dhe të survejohet' Nga Komanda e Grupit CC.RR e Tiranës iu sinjalizua Kuesturës Mbretërore të Firences si komunist, që rezulton i përfshirë në listën e personave të rrezikshëm që burgosen në rrethana të caktuara». («Heronj të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare». Përmbledhje dokumentesh, Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1984, f. 25)

Me këto të dhëna Qemal Stafa minimalisht duhej të ishte internuar në ndonjë ishull në Itali dhe jo të lejohej të shkonte për studime në Firence. Nasho Jorgaqi në librin e vet për Qemal Stafën shkruan: «kuestori italian i Tiranës, B. Skaminaci, kur i bie në dorë shkresa që bën fjalë për të drejtën që i është dhënë Qemalit të ndjekë studimet në Itali, shënon mbi të jo pa nervozizëm me laps të kuq: Dhe dërgojmë për studime një element të kësaj natyre?». (Nasho Jorgaqi:

«Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 262-263)

Pyetja e oficerit italian të policisë mund të kishte një përgjigje racionale vetëm nëse Qemal Stafa ishte agjent i shërbimit sekret italian dhe se në Itali shkoi për studime për shpërblim dhe me mision. Në një dokument të Luogotenencës (Mëkëmbësisë), autoritetit më të lartë shtetëror italian në Shqipëri, të 22 prillit 1940 thuhet: «Në Luogotenencën e Përgjithshme referohet nga rrugë e besuar, se studenti shqiptar pranë Universitetit Mbretëror të Firences, Qemal Stafa, që ka ardhur para pak ditësh në Shqipëri, ishte bërë nxitësi ndërmjet kolegëve të tij në Firence, për formimin e një bërthame komuniste në opozitë të plotë me regjimin».(cituar sipas librit: «Heronj të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare». Përmbledhje dokumentesh, Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1984, f. 24)

Pra, duket qartë se Qemal Stafa në Firence po bënte agjentin-provokator për të zbuluar rrethet studentore komuniste. E megjithatë, edhe pas kësaj nuk urdhërohet arrestimi i Qemal Stafës. Duket qartë se atë e mbronte OVRA, policia sekrete politike fashiste. Në 29 mars 1940, oficeri i lartë i policisë në Shqipëri, italiani A. La Verde raportonte për Qemal Stafën: «I sipërpërmenduri, sikurse më është thënë, është akuzuar tri herë si komunist dhe më 1939, përpara gjykatës(e ka fjalën për gjyqin e shkurtit 1939-K.M.), së cilës i ishte kaluar, kishte deklaruar hapur se ishte komunist. Për këtë motiv u arrestua dhe pastaj u internua». («Heronj të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare». Përmbledhje dokumentesh, Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1984, f. 23)

E megjithatë Qemal Stafa vazhdonte të shijonte Firencen si student në një fakultet të pëlqyer ku edhe bashkëmoshatarët italianë ëndërronin të studionin. Që Qemal Stafa ishte agjent i shërbimit sekret fashist, kjo u kuptua kur në nëntor 1940, me fillimin e Luftës Italo-Greke, ai u arrestua në Itali dhe u çua para Gjykatës Speciale të Romës, si njeri emri i të cilit ishte në listat e njerëzve të rrezikshëm. Por nuk u burgos dhe as u internua, se e mbrojti OVRA. Qemal Stafa u lirua dhe vazhdoi studimet. Urdhëri për arrestimin e Qemal Stafës doli vetëm në fund të tetorit 1941: «Me urdhër nga Roma i kërkohet Tiranës arrestimi i Qemal Stafës. Me teleks nr 71. 12739.3406 të datës 17 tetor, Ministria e Brendshme në Romë urdhëroi arrestimin e Qemal Stafës».(po atje f. 27)

Meqënëse urdhëri për arrestimin e Qemal Stafës vjen nga Roma, kuptohet se ky njeri ishte jashtë juridiksionit të autoriteteve të Mbretërisë Shqiptare dhe këtë status Qemalit mund t' ia jepte vetëm OVRA. Arrestimi i tij është urdhëruar në tetor 1941, dhe kjo ndodhi se atëherë ishte koha kur po themelohej PKSH, me ç' rast italianët donin që t' i rrisnin reputacionin Qemal Stafës, në mënyrë që ky të ngjitej sa më lart në hierarkinë komuniste dhe ta kontrollonte atë për llogari të tyre. Në 2 nëntor 1941, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë u drejtohet

kuesturave të Tiranës dhe Elbasanit, duke kërkuar arrestimin e menjëhershëm të Qemal Stafës: «Lutemi të bëni urgjentisht arrestimin dhe bastisjen e banesës së komunistit Stafa Qemal të Hasanit». (po atje: f. 27)

Në 3 nëntor 1941 Kuestura e Tiranës njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë se Qemal Stafa nuk gjendet dhe se kërkimet për të dolën të pafrutshme në Tiranë dhe në zona të tjera të vendit. Kuptohet se kjo ishte një lojë që bëhej për të rritur reputacionin e Qemal Stafës mes komunistëve, duke qenë se fotografia dhe emri i Qemal Stafës do të publikoheshin gjithandej dhe ai kështu do të bëhej i famshëm si i kërkuar. Për të tjerat e mbronte OVRA. Në 16 nëntor 1941 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Tiranë njofton kuesturën e Romës se: «Qemal Stafa dalë nga Shqipëria direkt për në Itali, nuk rezulton më i rikthyer as me rrugë ajrore, as me rrugë detare. Duke menduar megjithatë se ndërkohë ndodhet në Itali, lutemi t' u ipni instruksione organeve kompetente për ndalim». (po atje f. 28)

Këtu lind pyetja se kur është kthyer Qemal Stafa në Shqipëri nga Italia. Meqënëse vjen urdhri nga Roma për arrestimin e tij në fund të tetorit 1941, supozohet se ai ishte kërkuar që të arrestohej në Itali, para se të kërkohej arrestimi i tij në Shqipëri. Nasho Jorgaqi dhe krejt Historiografia zyrtare komuniste nuk na thonë se kur u kthye Qemal Stafa në Shqipëri nga Italia për të fundit herë. Në 1941 nuk mund të hyje në Shqipëri nga Italia në mënyrë ilegale se kontrolli në porte dhe aeroporte ishte shumë i rreptë për shkak se Italia kishte hyrë në luftë. Një gjë është e sigurt, që ai ka ardhur nga Italia pasi ishte shpallur në kërkim policor. Këtë e them për arsye se thuhet që ai nuk rezulton të jetë kthyer as me rrugë ajrore dhe as me rrugë detare. Në rrugë tokësore përjashtohej pasi rrugëkalimet tokësore nga ish-Jugosllavia e pushtuar i kontrollonin gjermanët në atë kohë. Për kthimin e Qemal Stafës në Shqipëri ka vetëm një shpjegim. Ai kishte hyrë në Shqipëri nëpërmjet OVRA-s, jashtë kontrollit të Policisë.

Vetëm kështu Qemal Stafa mundi të bënte atë gjë që nuk e bënë dot në atë kohë as Mehmet Shehu, as Petro Marko, as të tjerë. Këta erdhën në Shqipëri nga Italia si të arrestuar nga fashistët dhe këtu u liruan. Enver Hoxha në kujtimet e veta e quan Mehmet Shehun spiun të italianëve për mënyrën se si u kthye në Shqipëri në 1942, por nuk ngre asnjë dyshim për kthimin e Qemal Stafës.

Gjashtë muaj pasi u shpall në kërkim, Qemal Stafa do të vritej nga Policia, i rrethua në një shtëpi në qytetin e Tiranës. Për shtëpinë ku u rrethua Qemal Stafa Nasho Jorgaqi thotë: «Ishte një nga ato bazat e reja që qenë marrë pas zbulimit të bazave të vjetra. Por si bazë e re ishte akoma e paprovuar mirë. Veç kësaj ajo ndodhej përballë kazermave të artilerisë së ushtrisë italiane, në një vend të zhveshur, aq sa nga dritaret e saj të përparme mund të shihje me sy deri rruga e Dibrës lart... Qemali vinte për herë të parë në këtë bazë... Aty gjeti një shok të

Komitetit Qendror dhe tri vajza». (Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 408)

Si rrinte Qemal Stafa në një bazë kaq të papërshtashme dhe kaq të ekspozuar ndaj rrezikut dhe mbikqyrjes së fashistëve? Kuptohet se këtë e bënte për arsye se kishte garanci nga OVRA! Shoku tjetër që u gjend i rrethuar bashkë me Qemal Stafën ishte Kristo Themelko, anëtar i Komitetit Qendror të PKSH, i ngarkuar për çështjet ushtarake, ndryshe «Gjenerali Shule», siç quhej për shkak të origjinës sllavo-maqedone. Në shtëpinë në Tiranë ku u rrethua Qemal Stafa në 5 maj 1942 qenë strehuar gjashtë komunistë. Çuditërisht, ata qenë tre djem dhe tre vajza. Këta ishin Beqir Minxhozi, nga fshati Shllinë i Matit, i cili kishte marrë me qera shtëpinë, për "nevojat e luftës". Se kush ishte tjetër na e pohon Nexhmije Hoxha në kujtimet, kur tregon atë që i tha Enver Hoxha ditën e vrasjes së Qemalit: "Enveri nisi të më tregojë se i kishte ardhur shoku Gogo (Nushi), i cili ishte i vetmi nga Komiteti i Partisë për Tiranën që e dinte këtë bazë të fshehtë strehimi të Enverit. Ky kishte sjellë Shulen (Kristo Themelkon), i cili kishte qenë bashkë me Qemalin dhe kishte mundur t' i shpëtonte rrethimit. Kishte shpjeguar se aty kishin qenë dhe tri shoqe: Drita Kosturi, e fejuara e Qemalit, Maria, e fejuara e Ludovik Nikajt dhe Gjystina, që ishte kushërirë me Marien dhe e fejuar dhe e martuar me Zef Ndojën. Po mendohesha: që të ndodhej atje Drita, kuptohet se do të përcillte të fejuarin e vet, Qemalin, i cili atë ditë ose të nesërmen do të nisej për në Vlorë. Por ç' donin atje edhe ato dy shoqet e tjera, të cilat e njihnin Qemalin, po nuk kishin lidhje pune me të dhe as me Dritën?"(Nexhmije Hoxha, "Jeta ime me Enverin-kujtime", Enti botues "Lira", Tiranë 1998, Vëllimi I, f. 36)

Nexhmija e di shumë mirë se ç' donin dy "shoqet" në atë shtëpi. Ato ishin atje për të plotësuar numrin tre të femrave për tre meshkujt. Më qartë se kaq nuk mund të na e thoshte Nexhmija se Qemal Stafa kishte organizuar një orgji, apo e thënë ndryshe një festë ku do të kishte marrëdhënie seksuale në grup, në shtëpinë që ishte bazë ilegale e luftës. Shtëpinë pranë spitalit të Tiranës, e kishte marrë me qera Beqir Minxhozi, me porosinë specifike të Qemalit. Përse pikërisht pranë spitalit? Ndoshta për të lehtësuar ndonjë abort të mundshëm të "shoqeve". Që italianët nuk shkuan te shtëpia, ashtu siç duhej të shkonin për të arrestuar dy komunistë të rrezikshëm (Qemal Stafa dhe Kristo Themelko qenë anëtarë të Komitetit Qendror prej shtatë anëtarë të partisë komuniste), kjo kuptohet nga fakti se të gjithë mundën t' i ikin rrethimit, me përjashtim të Qemalit. Në të vërtetë te shtëpia u dërgua vetëm një patrullë karabinierie pas ankesave të banorëve të lagjes se në atë shtëpi bëhej orgji ditë-natë. Asnjëri nga ata të cilët qenë në shtëpi nuk ishte proletar i varfër. Kristo Themelko ishte pronar i një punishteje druri dhe ai kishte sjellë gramafonin, për të dëgjuar muzikë, dhe nga volumi i ngritur i gramafonit gjatë natës, u shqetësuan banorët e lagjes. Merret vesh, në një lagje tradicionale tiranase të asaj kohe, ngjarja ishte një skandal i padëgjuar. Prandaj Policia thirri qeramarrësin, Beqir Minxhozin për ta qortuar. Më pas u tha se ky ishte shkaku që Policia zbuloi bazën ilegale komuniste. Por nëse do të kishte qenë kështu, atëherë italianët do të kishin organizuar një operacion të vërtetë, duke rrethuar lagjen, dhe nuk do të mund të shpëtonte askush nga ata që

gjendeshin në shtëpi. Qemal Stafa qëndroi dhe nuk tentoi të largohej si të tjerët, se ai kishte dokumentin e bashkëpunëtorit të OVRA-s, me të cilin mendonte se mund të shpëtonte lehtësisht. Ai nuk e dinte se OVRA e kishte braktisur tashmë dhe se nuk e donte më të gjallë. OVRA kishte zgjedhur mes Enver Hoxhës dhe Qemal Stafës dhe zgjedhja kishte rënë mbi të parin. Në librin e Nasho Jorgaqit ngjarja përshkruhet, sipas dëshmive të protagonistëve, të cilët të gjithë qenë gjallë në atë kohë (Beqir Minxhozi dhe Kristo Themelko madje mbanin detyra jo të parëndësishme shtetërore në kohën që u botua libri i Nasho Jorgaqit): «të dy ilegalët u larguan disa hapa nga shtëpia, po ndërsa shoku i Qemalit hyri në një hendek më të djathtë të shtëpisë, nga ku kish mundësi të luftonte e të mbrohej, Qemali qendroi, duke u angazhuar në luftë me armiqtë, për të siguruar tërheqjen e shokut... Pasi hodhi edhe bombën e dytë, nisi të vraponte nëpër kopshtin e gjelbëruar dhe doli në fushë të hapur».(Nasho Jorgaqi: «Qemal Stafa», Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1970, f. 411)

Në fakt Qemali qëndroi për mos të rrezikuar veten, siç është udhëzimi për agjentët e infiltruar në lëvizje subversive kur bien në prita të tilla. Qemali mendonte se kjo ishte një goditje e rastësishme dhe ai qendroi pas që të dorëzohej, me mendimin se kur ta kapnin OVRA do ta shpëtonte. Qemal Stafa u vra nga padronët e tij dhe ironikisht njeriu që e kërkoi kokën e tij, Enver Hoxha, kur erdhi në pushtet e bëri ditën e vrasjes së Qemalit ditën e përkujtimit të gjithë dëshmorëve. Aventura e këtij agjenti të kalibrit të lartë në historinë e spiunazhit shqiptar nuk është shkruar ende hollësisht, por që ishte një agjent i shumëfishtë duket qartë.

Kur Qemal Stafa u gjend përballë Policisë fashiste në 5 maj 1942, ai tentoi të bënte atë që bëri Enver Hoxha në 29 tetor 1942, kur shkuan ta arrestojnë karabinierët italianë. Enver Hoxha shkruan në kujtimet e veta për episodin kur fashistët shkuan ta arrestojnë në dyqanin e tij «Flora», të nesërmen e demonstratës së 28 tetorit 1941, në Tiranë:

«Që të nesërmen u detyrova të hidhesha në ilegalitet. Ka edhe kjo historinë e vet. Në mëngjesin e 29 tetorit në «Flora» ia behën karabinierët. Dy prej tyre, krekosur me rripa meshini kryq e tërthor krahërorit e me këllëfët e revolverëve të hapur, hynë brenda, të tjerët qëndruan jashtë. Vetëm ato çaste e ndiem se ç' gabim të madh kishim bërë. Kishim menduar se në rrëmujën e madhe të përleshjes së djeshme, në mes atyre qindra e mijëra demonstruesve, që tundën Tiranën, fashistët nuk na kishin identifikuar. E ja ku tani, thuajse të gjithë ne «punëtorët» e «Florës» ndodheshim përpara çarkut të tmerrshëm.

-Enver Hoxha!- thirri njëri nga karabinierët.- Dove e Enver Hoxha?!

Pilos e Ilo Dardhës që ndodheshin në banak u ngrinë pecetat në duar. Pasoi një çast heshtjeje, por unë ndërkaq e mblodha veten dhe nga arka e «pronarit ortak», zgjata kokën e gjithë

'xhentilecë' provova të vetmen mundësi që mund të provohej:

-Ja këtu brenda është, prisni, ju lutem, ta lajmëroj,- u thashë me zë të qetë e me gjeste të një 'gatishmërie' kaq shembullore, sikur mezi prisja rastin t' u bëja pepinove një shërbim të çmuar!

Kisha goditur në shenjë. Më besuan. Hyra në pjesën e brendshme të dyqanit, duke thirrur me zë të lartë, 'Enver, të kërkojnë', hapa me shpejtësi deriçkën e pasme, të çelur apostafat për raste të tilla, u lëshova në një rrugicë të ngushtë, kapërceva në oborrin e një plake të vetmuar dhe prej andej, duke i rënë mes për mes 'lagjes së çobanëve'përshkova 'i qetë', por me sytë katër bulevardin e madh. Pas disa çastesh kur hyra në lagjen popullore, matanë bulevardit, u binda se fashistëve vetëm emri u kishte mbetur në duar».(Enver Hoxha: «Kur lindi Partia», Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1981 f. 160- 161)

Ky tregim i Enver Hoxhës është një përrallë për kalamajtë. Kur karabinierët italianë, të cilët ishin profesionistë, shkonin të bënin arrestimin e një antifashisti të rrezikshëm, nuk shkonin verbërisht, por bënin një plan sipas manualeve përkatëse. Në këtë plan merreshin masa që identifikohej personi që kërkohej të arrestohej, si dhe rrethohej vendi që t' i pritej këtij çdo mundësi ikjeje. Kështu ndodhi kur fashistët shkuan të arrestojnë Qemal Stafën, Vojo Kushin dhe shokët e tij, Perlat Rexhepin dhe shokët e tij. Por në rastin e Enver Hoxhës nuk ndodhi kështu?! Është krejt e pabesueshme që karabinierët dhe agjentët e OVRA, të cilët sigurisht qenë bashkë me ta, të shkonin për të arrestuar Enver Hoxhën pa pasur me vete asgjë për identifikimin e tij. Karabinierët kur shkuan të arrestojnë Enver Hoxhën, duhet të kishin me vete një fotografi të tij, çka qe rregulli minimal në këto raste. Këtë fotografi ata mund ta kishin siguruar ose nga fotografitë që bënë gjatë demonstratës së një dite më parë, ose nga dosja e Enver Hoxhës, derisa ai pretendon se është pushuar nga puna si mësues në Lice, për veprimtari antifashiste.

Edhe sikur italianët ta kenë bërë gabimin diletant, që të mos kishin me vete fotografinë e personit që kërkonin, nuk mund të pranohet që ata të kenë bërë gabimin e dytë krejt prej diletanti, që të mos rrethonin ndërtesën dhe një zonë të gjerë rreth saj. Sipas manualeve që zbatoheshin në këto raste, nuk lejohej të dilte askush nga zona e rrethuar, që në momentin që fillonte aksioni për arrestimin e personit apo personave të kërkuar. Në rast se sinjalizohej që aksioni qe kryer me sukses, atëherë zona çbllokohej, ndërsa në rast se sinjalizohej se të kërkuarit nuk ishin gjetur në ndërtesë, atëherë fillonte krehja e zonës, domethënë kontrolli i imtësishëm i saj. Kështu ndodhi kur u vranë Qemal Stafa, Vojo Kushi, Perlat Rexhepi, si dhe në shumë raste të tjera, kur italianët nuk qenë treguar aq idiotë sa të hynin nga dera kryesore, duke mos e rrethuar ndërtesën dhe zonën, duke u dhënë kështu mundësi të kërkuarve që të largoheshin nga dera e pasme, ose nga muret e oborrit të shtëpive. Në të gjitha rastet, veç atij të Enver Hoxhës, italianët rrethonin ndërtesën dhe madje gjithë lagjen, siç thotë kënga për

Perlat Rexhepin dhe shokët e vet: «Drita dal ka herë,/ç' po troket një derë./Çelnie mor të mjerë,/se nuk ikni dot!»

Madje italianët, në rastin e Enver Hoxhës bënë dhe gabimin e fundit diletant, duke mos e shoqëruar personin i cili u tha se po shkonte të njoftonte atë që ata kërkonin. Enver Hoxha kërkon të na bëjë të besojmë se karabinierët menduan se kur i kërkuari të mësonte se po e kërkonin karabinierët, nuk do të ikte, por do të paraqitej vetë tek ata? Qemal Stafa, Vojo Kushi, Perlat Rexhepi etj., del se qenkan treguar shumë idiotë, se kur u trokitën fashistët në derë të shtëpisë, nuk shkuan t' u hapin derën dhe t' i pyesin se kë kërkojnë, pastaj t' u thotë se Qemal Stafa, Vojo Kushi, Perlat Rexhepi janë brenda dhe se po shkojnë t' i lajmërojnë. Sipas eksperiencës të Enver Hoxhës me karabinierët, fashistët duhet të prisnin te dera kryesore, duke pasur kështu mundësi të kërkuarit të dilnin nga dera e pasme.

Ajo që i ndodhi Enver Hoxhës në 29 tetor 1941 ishte rasti klasik i lojës që bëhet për t' i dhënë kredibilitet një agjenti. Enver Hoxha, pasi del nga dera e pasme e dyqanit «Flora», që gjendet pak metra larg kryqëzimit ku priten Rruga e Barrikadave me Rrugën e Dibrës, në rrugën që lidh kryqëzimin në fjalë me Sheshin «Skënderbej», në vend që të vazhdojë të ecë në rruginat e lagjes për të dalë jashtë Tiranës në drejtimin ku sot është stacioni i trenit, kthehet majtas, duke dalë në atë që sot është Bulevardi «Zog I» (vazhdimi i bulevardit kryesor). Kapërcen dhe bulevardin për të hyrë në lagjen që ishte në anën tjetër, pra në bllokun mes Bulevardit «Zog I» dhe Rrugës së Durrësit. Në një kthesë, në të djathtë të Rrugës së Durrësit, pra në bllokun ku u fut Enver Hoxha, ishte shtëpia e Esat Dishnicës, të cilin të gjithë e njihnin si mik të Enver Hoxhës, dhe ku duhej të shkonin së pari fashistët për ta kërkuar.

Qemal Stafa, kur pa se policët që kishin shkuar te shtëpia ku strehohej ai, nuk u sollën ashtu siç duhej të silleshin pasi ai ua bëri me dije se cili ishte, dyshoi, dhe tentoi të largohej me vrap. Atëherë e vranë. Merret vesh, OVRA as që i dha shpjegime të hollësishme Policisë, dhe dokumentin që kishte Qemal Stafa e ka quajtur të rremë. Me vrasjen e Qemalit, kur Policia pa se i kishte rënë në dorë një nga komunistët kryesorë, atëherë disa oficerë të cilët donin të fitonin grada, sajuan në letër historinë e operacionit të kryer për rrethimin e bazës ilegale komuniste.

Nëse e shohim Qemal Stafën si simbol antifashist, ai është sigurisht një simbol shumë i papërshtatshëm. Qemal Stafa vërtet ishte antifashist, por ishte një antifashist i llojit kominternian, stalinist, do të thotë i llojit të atyre që e përdornin antifashizmin si kamuflim për të marrë pushtetin me anë të luftës civile. Sepse është një fakt historik se brenda së majtës komuniste shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore ka pasur dy rryma, një që mund të quhet moskovite, kominterniste, staliniste, ekstremiste, dhe një tjetër, e një komunizmi refraktar ndaj

Moskës, por megjithatë antifashist, properëndimor, të moderuar, një debat dhe konflikt të madh, që precipitoi deri në luftë civile brenda lëvizjes komuniste, mes krahut stalinist, kominternist, ekstremist, të përfaqësuar nga Enver Hoxha, Qemal Stafa, Vasil Shanto, Hysni Kapo etj., dhe krahut antistalinist, të moderuar, të ashtuquajtur trockist, të përfaqësuar nga Zai Fundo, Sadik Premte, Anastas Lulo etj. Në rezolucionin e Mbledhjes themeluese të PKSH, në nëntor 1941, thuhet: «Një nga ligjet themelore të zhvillimit të partisë së tipit të ri, të partisë bolshevike, është lufta në dy fronte kundër gabimeve të vetvetes dhe veçanërisht kundër tentativës së krijimit të grupeve dhe lufta pa pajtim kundër armikut të klasës». (cituar sipas: «Dokumente kryesore të PPSH», botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë 1960, Volumi i parë, dokumenti nr. 1, f. 19).

Qemal Stafa ishte një nga ata të cilët e firmuan këtë rezolucion, në emër të Komitetit Qendror të PKSH, pre shtatë anëtarësh, që doli nga mbledhja themeluese e partisë. Me këtë dokument të firmuar dhe nga Qemal Stafa, PKSH, që në dokumentin e saj themelues shpallte së pari luftën civile në radhët e lëvizjes komuniste në Shqipëri, si një luftë e stalinistëve kundër të komunistëve të tjerë që konsideroheshin si trockistë dhe që nuk pranonin vijën staliniste të Kominternit, që e kishte qendrën në Moskë.

Me këto rreshta të rezolucionit, dokumentit themelues të PKSH, përgënjeshtroheshin të gjitha parimet e shpallura publikisht nga PKSH për bashkim të popullit shqiptar pa dallim ideje, krahine dhe feje, në luftën kundër pushtuesve fashistë. Por e vërteta ishte se në rezolucionin themelues të PKSH, që gjatë luftës nuk u publikua (u publikua për herë të parë në vitin 1960), në Shqipëri, në fakt shpallej lufta kundër atyre që kishin ide të ndryshme nga komunistët stalinistë, si brenda lëvizjes komuniste, ashtu dhe jashtë saj. Faji i vetëm i këtyre njerëzve ishte se nuk pranonin diktatin e komunistëve stalinistë. Qemal Stafa ishte një nga firmëtarët e rezolucionit të Konsultës së parë të Aktivit të PKSH, të mbajtur në prill 1942, ku thuhet: «Të luftojmë pa mëshirë grupin e 'Zjarrit', trockistët Zai Fundo, Aristidh Qendro, Niko Xoxi dhe të gjithë armiqtë e partisë, të cilët përpiqen në çdo mënyrë të pengojnë punën e partisë».(çituar sipas: «Dokumente kryesore të PPSH», botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë 1960, Volumi i parë, dokumenti nr. 9, f. 64) Dhe rezolucioni i prillit 1942 mbyllet me fjalët: «Rroftë partia bolshevike dhe shoku Stalin!»

Të ashtuquajturit trockistë ishin komunistë që ishin antifashistë, por faji i tyre ishte se ishin edhe antistalinistë. Faji i Zai Fundos dhe të ashtuquajturve trockistëve të tjerë ishte se ata ishin deziluzionuar nga stalinizmi pas spastrimeve masive të përgjakshme të tij, dhe nuk e pranon këtë komunizëm brutal. Faji i tyre ishte se ata nuk besonin tek strategjia staliniste e përçuar nëpërmjet Kominternit që lufta botërore duhej përdorur nga partitë komuniste, që nëpërmjet ekspedientit të antifashizmit, të merrej pushteti dhe të vendosej regjimi komunist në vendet ku vepronin këto parti. Të ashtuquajturit trockistë si Zai Fundo, zjarristët, e më pas Anastas Lulo

dhe Sadik Premte besonin se në kushtet e Shqipërisë që ishte një vend i prapambetur kryesisht fshatar, gjysmë-feudal dhe patriarkal-fisnor, nuk mund të vendosej komunizmi, pasi do të dështonte dhe prandaj nuk duhej përdorur lufta antifashiste për marrjen e pushtetit nga komunistët, por duhej bërë një aleancë e sinqertë me antifashistët jokomunistë, ndërsa sa për ardhjen në pushtet të komunizmit kjo i duhej lënë së ardhmes, kur vendi të përparonte dhe të shndërrohej në vend borgjez nga vend feudo-borgjez (sipas terminologjisë komuniste). Pra, faji i të ashtuquajturve trockistë shqiptarë ishte se ata donin që sloganet zyrtare të PKSH që të bëhej luftë antifashiste, në aleancë me jokomunistët, pa dallim ideje dhe çështja e pushtetit të zgjidhej pas lufte, të merreshin seriozisht dhe jo siç bënte PKSH, që i shikonte si «gjethe fiku» që mbulonin lakuriqësinë e politikës së saj për pushtet. Duket qartë se për PKSH, armiqtë ideologjikë, të ashtuquajturit trockistë, qenë më të rrezikshëm se pushtuesit e huaj fashistë, pasi PKSH e abandononte parimin e shpallur për bashkim pa dallim ideje, në luftë kundër pushtuesve fashistë për hir të luftës kundër këtyre kundërshtarëve ideologjikë. Lufta kundër tyre nuk ishte luftë antifashiste, por luftë kundër të ndryshmëve ideologjikë, luftë e stalinistëve kundër antistalinistëve.

Grupi komunist «Zjarri» luftohej nga PKSH se, jo vetëm që nuk pranoi të hyjë në PKSH, por e quante veten parti komuniste. Pra lufta e PKSH kundër grupit «Zjarri» ishte luftë kundër të ndryshmit ideologjik. Edhe rezolucioni i prillit 1942 nuk u publikua deri në vitin 1960. Kjo luftë çivile ideologjike brenda radhëve të lëvizjes komuniste vazhdoi e përgjakshme gjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore, madje edhe pas saj. Protagoniste e kësaj lufte qe udhëheqja staliniste e PKSH që i spastroi kundërshtarët e saj antistalinistë, duke i asgjësuar fizikisht në atentate dhe fushata terroriste. Qemal Stafa ishte ideator i këtyre krimeve. Siç e thashë më lart, në luftën ideologjike të përgjakshme mes këtyre dy rrymave Qemal Stafa ishte në anën e stalinistëve, si anëtar i Komitetit Qendror provizor të PKSH prej shtatë vetësh (atëherë Komiteti Qendror ishte organi më i lartë i partisë pasi ende nuk ishte krijuar Byroja Politike), dhe si i tillë i nënshkroi të gjitha këto dokumente dhe punoi për realizimin e tyre. Ditën që u vra, në 5 maj 1942, Qemal Stafa do të nisej për në Vlorë, ku do të punonte për zbatimin e rezolutës të aktivit të PKSH për luftë kundër trockistëve, pra kundër komunistëve antistalinistë. Në raportin që Koço Tashko, i dërguari i Kominternit në Shqipëri i shkruante Moskës në vitin 1942, shprehej për Qemal Stafën: «Sikundër më tha një shok i KQ të Rinisë dhe i KQ të Partisë (shoku më aktiv dhe njëkohësisht më sektar mbi të cilin mbështetej shoku Miladin), s'na duhen më këta naçionalistë se këta nesër do të jenë armiqtë tanë». (cituar sipas: «Politika antikombëtare e Enver Hoxhës», Plenumi II i Beratit, dokumente, Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, Tiranë 1995, f. 192.)

Ndonëse Koço Tashko nuk e përmend me emër Qemal Stafën, kuptohet se është fjala për të. Në letër flitet në të shkuarën për këtë «shok», që do të thotë se ai ka vdekur në kohën që shkruhej letra. Dhe i vetmi njeri atëherë që kishte qenë anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste, i cili nuk ishte më gjallë, ishte Qemal

Stafa. Nga letra, kuptohet se Qemal Stafa ishte aq ekstremist sa e shikonte me skepticizëm dhe strategjinë kominterniane të përdorimit të «kalit të drunjtë» (Frontit antifashist me jokomunistët), për të kamufluar partinë në rrugën drejt pushtetit. Qemal Stafa nuk ka qenë pjesëtar i forcave të armatosura antifashiste, ai nuk ka qenë pjesëtar i asnjë reparti partizan, çka do të bënte që të justifikohej invokimi i emrit të tij si simbol i luftës antifashiste. Të vetmet poste të Qemal Stafës gjatë luftës qenë ato të anëtarit të Komitetit Qendror të PKSH dhe të sekretarit të përgjithshëm të Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare. Të dy këto qenë poste ideologjike. Pra, fashistët, në rastin më të mirë e vranë Qemal Stafën si kundërshtar ideologjik. Qemal Stafa nuk u vra si pjesëtar i një reparti partizan që luftonte kundër pushtuesve italianë, por si komunist. Qemal Stafa duket se u vra i tradhtuar nga Enver Hoxha, që ishte xheloz për të, se siç thotë Tashko, Miladin Popoviçi e kishte në atë kohë Qemal Stafën bashkëpunëtorin më të ngushtë. Veprën e Qemal Stafës, për spastrimet staliniste në radhët e lëvizjes komuniste, si dhe brenda vetë partisë, vepër të cilën ky e la përgjysmë, e vazhduan shokët e vet komunistë stalinistë, Enver Hoxha dhe të tjerët. PPSH gjatë gjysmë shekulli në pushtet ndoqi traditën e rrymës staliniste.

Në mbledhjen promovuese të Fondacionit politik "Qemal Stafa" të PS, në shtator 2007, kryetari i PS, Edi Rama u shpreh: "Premtojmë për të vendosur në këtë mënyrë një raport të ri me zgjedhësin në funksion të një kontrate dhe fondacioni që Qemal Stafa në një mënyrë të caktuar të jetë noteri i kësaj kontrate që ne do të nënshkruajme me qytetarët dhe qytetaret e këtij vendi".

Por, nëse "Qemal Stafa" do të jetë noter i PS, siç e quan Edi Rama, ai është noteri që e lidh me Kominternin, me Moskën, me PKSH. PS është një parti që "noterinë" ku ka depozituar aktin e e krijimit dhe ku ka marrë miratimin e për krijimin e saj e ka në Moskë. Se PKSH, pasi u krijua në nëntor 1942 bëri kërkesë për miratim në zyrat e Kominternit në Moskë dhe e bëri konstituimin vetëm pasi i erdhi miratimi nga Moska. Edhe për PS "noteria" mbetet në Moskë, se në 1991 kur PPSH ndryshoi emrin, ajo në kundërshtim me ligjin shqiptar të kohës për partitë politike, depozitoi në Ministrinë e Drejtësisë vetëm ndryshimet që bëri në Kongresin e qershorit 1991, në një kohë që ligji parashikonte një procedurë me depozitim të një numri firmash dhe programin e statutin.

Prorusët në Shqipëri u ngazëllyen kur panë Ambasadorin e Rusisë që vendoste një kurorë te Monumenti ë stilit sovjetik "Nënë Shqipëri", së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë. Prorusët u ngazëllyen kur Rusia aneksoi Krimenë dhe mezi po presin që të njëjtën gjë ta bëjë edhe me Ukrainën Lindore. Ata njerëz në Shqipëri të cilët kanë vuajtur nga orientimi ë Shqipërisë kah Rusia, dhe sot janë të shqetësuar nga rifuqizimi dhe revanshi ë Rusisë, u indinjuan kur panë që në vitin 2014, Kryeministri ë Shqipërisë vendos kurorë së bashku me Ambasadorin rus te një

monument sovjetik në Tiranë.

Por, kur edhe Ambasadori amerikan në të njëjtën ditë nderon Qemal Stafën, gjërat marrin një kuptim tjetër. Këtu nuk ka të bëjë aleanca antifashiste sovjeto-amerikane e Luftës së Dytë Botërore, se Qemal Stafa përfaqëson pikërisht ata njerëz që e detyruan SHBA të hynte në konflikt me Rusinë pas fitores mbi Fashizmin, për shkak të përdorimit të antifashizmit për ekspansionin botëror të Komunizmit.

Me përkujtimin e Qemal Stafës sot, Ambasadori Arvizu provokoi shumë rëndë atë pjesë të shqiptarëve të cilët kanë vuajtur shumë nga orientimi që i dha Shqipërisë Qemal Stafa dhe të tjerët si ai, duke keqpërdorur antifashizmin, sipas manualeve të Kominternit. Kur SHBA nderojnë zyrtarisht agjentët e Kominternit të Moskës në 2014, të cilët e përdorën luftën antifashiste si kamuflim për një lëvizje terroriste për marrjen e pushtetit, atëherë pse të mos jenë të legjitimuar edhe të tjerët sot që të marrin paratë dhe armët e Moskës, për të bërë në Shqipëri kryengritjen antiamerikane, duke e luftuar Qeverinë shqiptare si kolaboracionistë të pushtuesve amerikanë? Nesër pastaj mund të bëhemi përsëri miq me amerikanët, se rruga e miqësisë më të fortë me SHBA kaloka qartësisht nga Moska.

Gjesti i Ambasadorit amerikan sot është nga ato gjeste që mund të kenë pasoja fatale për stabilitetin e një vendi të NATO-s si Shqipëria. Arvizu dhe ata që janë pas tij duhet ta dinë dhe sigurisht që e dinë mirë se në ditët më të errëta të Luftës së Ftohtë Rusia komuniste jepte goditje në pikat më të dobëta të Aleancës Atlantike, sipas parimit subversiv leninist se zinxhiri këputet atje ku hallka është më e dobët. Duhet pritur që Rusia ta bëjë të njëjtën gjë edhe sot, madje sot më tepër se kurrë që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë klasike. A nuk është Shqipëria vendi më i përshtatshëm i NATO-s për t' u bërë diçka e tillë?

Kastriot Myftaraj

5-Maj-2014